



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Durrës më 26.07.2021

Lënda : Njoftim për konsultim publik të projekt-vendimit

Në mbështetje të nenit 18, të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak Durrës përpara shqyrtimit dhe miratimit të disa akteve zhvillon konsultime.

Me dorëzimin pranë Sekretares së Këshillit Bashkiak të Projekt-Vendimit dhe Relacionit **“PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE Durrës, TË AMBJENTIT ME SIPËRFAQE NDËRTIMI 199 M² DHE SIPËRFAQE FUNKSIONALE 21.4 M², E NDODHURUR NË KATIN E PARË TË SHKOLLËS “JAN KUKUZELI”, PRONË E BASHKISË Durrës, PËR NJË AFAT KOHOR 1 VIT, ME TË DREJTË RIPËRTËRITJE, PËR T’U PËRDORUR PËR ADMINISTRATËN E KËSAJ DREJTORIE”**, të propozuar nga Zëvendëskryetarja e Bashkisë Durrës, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak ka nisur procesin e Konsultimit Publik.

Në kuadër të këtij procesi, Këshilli Bashkiak publikon këtë projekt-vendim, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al), sipas parashikimeve të ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Për këtë qëllim, mirëpresim çdo koment dhe sugjerim Tuajin, mbi këtë projekt-vendim, të cilat duhet të dërgohen në adresën e e-mail : keshillidurres@gmail.com, brenda 20 ditëve nga publikimi në faqe.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Dorina Milja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

PROJEKTVENDIM

NR. _____, DATË ___/___/2021

PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE DURRËS, TË AMBJENTIT ME SIPËRFAQE NDËRTIMI 199 M² DHE SIPËRFAQE FUNKSIONALE 21.4 M², E NDODHURUR NË KATIN E PARË TË SHKOLLËS “JAN KUKUZELI”, PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT KOHOR 1 VIT, ME TË DREJTË RIPËRTËRITJE, PËR T’U PËRDORUR PËR ADMINISTRATËN E KËSAJ DREJTORIE

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenin 901 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 69/2012 “ Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shkresës nr. 300/2 prot., datë 24.06.2021, ardhur nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, administruar nga Bashkia me nr. 7684 prot., datë 28.06.2021, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore dhe Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Sporteve, Komuniteteve Fetare, zëvendëskryetari i Bashkisë, i propozon Këshillit Bashkiak,

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin për dhënie në përdorim, pa kundërshtëpërblim, Drejtorisë Rajonale Arsimore Parauniversitare Durrës, të ambjentit me sipërfaqe ndërtimi 199 m² dhe sipërfaqe funksionale 21.4 m², e ndodhurur në katin e parë të shkollës “Jan Kukuzeli”, pronë e Bashkisë Durrës, për një afat kohor 1 vit, me të drejtë ripërtëritje, për t’u përdorur për administratën e kësaj Drejtorie.
2. Ngarkohet Drejtoria Ligjore dhe Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA E AKRSKF
Adrian Gurra

DREJTORIA LIGJORE
Arben Isaku

ZËVENDËSKRYETAR
Emiriana Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

RELACION

**MBI MIRATIMIN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM,
DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE DURRËS, TË
AMBJENTIT ME SIPËRFAQE NDËRTIMI 199 M² DHE SIPËRFAQE FUNKSIONALE
21.4 M², E NDODHURUR NË KATIN E PARË TË SHKOLLËS “JAN KUKUZELI”,
PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT KOHOR 1 VIT, ME TË DREJTË
RIPËRTËRITJE, PËR T’U PËRDORUR PËR ADMINISTRATËN E KËSAJ DREJTORIE**

PARA KËSHILLIT BASHKIAK

K ë t u

Projektvendimi që po ju paraqesim për miratim, ka për qëllim dhënie në përdorim, pa kundërshtëpërbllim, Drejtorisë Rajonale Arsimore Parauniversitare Durrës, të ambjentit me sipërfaqe ndërtimi 199 m² dhe sipërfaqe funksionale 21.4 m², e ndodhurur në katin e parë të shkollës “Jan Kukuzeli”, pronë e Bashkisë Durrës, për një afat kohor 1 vit, me të drejtë ripërtëritje, për t’u përdorur për administratën e kësaj Drejtorie.

Sqarojmë këshilltarët se indicien për të paraqitur për shqyrtim e miratim këtë projektvendim, administrata e Bashkisë e ka marrë nga Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare Durrës, e cila nëpërmjet shkresës që mban nr. 300/2 prot., datë 24.06.2021, i kërkon Bashkisë Durrës që ti ofrojë një ambjent pune, me vendodhje në shkollën “Jan Kukuzeli”, për t’a përdorur për funksionimin e Drejtorisë Rajonale Arsimore. Ky ambjent është kërkuar që t’i jepet në përdorim, pa kundërshtëpërbllim.

Bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 69/2012 “ Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore, e për rrjedhojë dhe Bashkia Durrës, ka detyrimin që të mbështesë institucionet e sistemit parauniversitar, përfshi dhe kërkuuesin, për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor.

Sqarojmë se nëse kërkuesi do të ushtronte funksionet vetëm në juridiksionin administrativ të Bashkisë Durrës, e përcaktuar kjo me ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk do ishte e nevojshme marrja e miratimit të këshillit. Referuar Urdhrit nr. 68, datë 05.04.2019 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe

Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar”, del se kërkuesi ka juridiksion administrativ dhe lëndor në disa Bashki të vendit, dhe jo vetëm në Bashkinë Durrës.

Ndodhur në këto kushte, të shtrirjes së juridiksionit territorial dhe lëndor të kërkuesit jashtë juridiksionit territorial të Bashkisë Durrës, i drejtohem këshillit, për të vendosur për dhënien në përdorim, pa kundërshtëpërblim, të ambjentit të kërkuar nga institucioni arsimor parauniversitar (Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës).

Bëjmë me dije se ambjenti i kërkuar nuk cënon procesin e mësimdhënies apo funksionimin e aktivitetit të shkollës “Jan Kukuzeli”. Është menduar që koha për dhënien me qira të jetë 1 vit. Nëse brenda këtij afati institucioni kërkues nuk do të akomodohet me zyra dhe ambiente të tjera nga ministria e linjës, ky afat do të shtyhet edhe për një vit.

Të gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen e ambjentit objekt i këtij shqyrtimi administrativ, shpenzimet për furnizim me energji elektrike, ujësjellës-kanalizime, do të përballohen nga huamarrësi, detyrime të cilat do të parashikohen në kushtet e kontratës së huapërdorjes.

Nëse do t’i referohemi Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 27.2.2019 “ Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”, del se të gjitha funksionet e kërkuesit lidhen me objektin e punës që kanë institucionet arsimore të sistemit parauniversitar, i parashikuar nga ligji nr. 69/2012 “ Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyrime sipas këtij ligji, si dhe në ligjin e posaçëm të qeverisjes vendore, të mbështesë institucionet e arsimit parauniversitar.

Bashkëlidhur dokumentacionin:

- Shkresa nr. 300/2 prot., datë 24.06.2021, ardhur nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, administruar nga bashkia me nr. 7684 prot., datë 28.06.2021, me lëndë: “Kërkesë për marrjen në përdorim pa qira të ambjentit të shkollës “Jan Kukuzeli”.
- Çertifikatë për vërtetim pronësie me numër 1886854, datë lëshimi 08.02.2019.
- Genplani i pronës që kërkohet të jepet në përdorim, pa kundërshtëpërblim.

**SEKTORI PRONAVE PUBLIKE
DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE**

Irma Bushi

SEKTORI ARSIMIT

Nikoleta Rusha

Konc. Aleks Prenga